

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7169
E hënë, 22 prill 2024
Çmimi 0.50

Dhoma e Përfaqësuesve
miraton ndihmën
ushtarake për Ukrainën
dhe Izraelin | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DËSHTON INICIATIVA PËR LARGIMIN E KRYETARËVE SHQIPTARË NË VERI | FAQE 4-5



Në katër komnatat e banuara me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq, të dielën është votuar për largimin e katër kryetarëve

shqiptarë. Megjithatë kjo iniciativë ka dështuar pasi në këtë proces nuk kanë marrë pjesë 50 për qind plus 1 e votuesve. Në total kanë votuar 253 persona. Lista Serbe i ka

ftuar votuesit për bojkot me arsyetimin se listat e votuesve "nuk e pasqyrojnë gjendjen reale në terren", duke thënë se numri i shqiptarëve në listat e votuesve "ishite rritur"

ME NDERIME TË LARTA SHTETËRORE I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT ISH-KOMANDANTIT TË UÇK-së, GANI IMERIT | F. 6



PAS SHKARKIMIT NGA KRYETARI I PRESHEVËS, SHQIPRIM ARIFI THOTË SE NUK DO TË MERRET MË ME POLITIKË | F. 3

AKTUALE



"TIKTOK"-U PARALAJMËRON SE NDALESA EVENTUALE NË SHBA DO TA "CENOJË FJALËN E LIRË" | F. 2

PDK-ja ANGAZHON POTENCIALIN PROFESIONAL TË DIASPORËS | F. 3

GRATË E KOSOVËS SHKRUAJNË HISTORI, SËRISH SHTETI YNË PREK MAJAT E SUKSESIT BOTËROR NË ART | F. 6

EKONOMI



PËR HERË TË PARË KOSOVA MERR VLERËSIM KREDITOR | F. 7

HOTI NGRE ALARMIN PËR MUNGESË TË INVESTIMEVE KAPITALE, KËRKON RISHIKIM TË POLITIKAVE FISKALE | F. 8

SPORT



LLAPI MPOSHTI FUSHËN KOSOVËN, PRISHTINA U RIKTHEHET FITOREVE | F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kievi mirëpret ndihmën e miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve

Ukraina dhe aleatët e saj evropianë kanë mirëpritur vendimin e Dhomës së Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara që miratoi paketën e ndihmës ushtarake për Kievin në vlerë prej 61 miliardë dollarësh, e cila tani duhet të miratohet nga Senati para se presidenti amerikan Joe Biden ta nënshkruajë që të hyjë në fuqi. Furnizimet për Ukrainën do të përfshijnë municione dhe

mbrojtje ajrore dhe janë pjesë e një pakete në vlerë prej 95 miliardë dollarësh që përfshin ndihmën për Izraelin dhe aleatët e tjerë të ShBA-së, sikurse Tajvani, i cili përballet me kërcënime potenciale nga Kina. Votimi i 20 prillit u arrit me mbështetjen e demokratëve dhe republikanëve të moderuar. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se

vendimi i ShBA-së “do të shpëtojë mijëra e mijëra jetë”. “Ne shpresojmë që projektligji do të mbështetet në Senat dhe do t’i dërgohet presidentit Biden. Faleminderit Amerikë! Demokracia dhe liria gjithmonë do të kenë rëndësi botërore dhe kurrë nuk do të dështojnë për aq kohë sa Amerika ndihmon në mbrojtjen e tyre”, shkroi Zelensky në rrjetet sociale.



‘TikTok’-u paralajmëron se ndalesa eventuale në ShBA do të ‘cenojë fjalën e lirë’



WASHINGTON, 21 PRILL - Zyrtarë të platformës “TikTok” kanë thënë se një ndalesë potenciale në përdorim të aplikacionit në Shtetet e Bashkuara “do ta cenonte fjalën e lirë” të 170 milionë amerikanëve. Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara ka votuar për ta ndaluar “TikTok”-un nëse pronarja e aplikacionit nuk shkëput lidhjet me Kinën. Legjislacioni ka qenë pjesë e një pakete masive të politikave të jashtme amerikane, që ka përfshirë edhe ndihmën për

Ukrainën. Dokumenti mund të shndërrohet në ligj javën që po vjen. Në muajt e fundit zyrtarët amerikanë kanë ngritur alarmin për popullaritetin që gëzon “TikTok”-u te gjeneratat e reja. Ata dyshojnë se kompania që zotëron “TikTok”-un, ByteDance, është e lidhur me Pekinin, ndonëse zyrtarë të saj i hedhin poshtë këto akuza. Zyrtarë të platformës kanë thënë se Byte Dance “nuk është agjente e Kinës dhe e asnjë

shteti tjetër”, derisa vetë Byte Dance insiston që nuk është kompani kineze, duke përmendur faktin që shumë kompani të mëdha për investime zotërojnë 60 për qind të aksioneve të saj. Nëse projektligji miratohet edhe në shkallët pasuese, ByteDance do të ketë nëntë muaj që t’i shesë aksionet - me mundësi të një shtyrjeje për tre muaj tjetër, nëse shitja është në proces e sipër - ose do të përballet me ndalesë. E themeluar më 2012 nga

sipërmarrës kinezë, Byte Dance e ka prekur suksesin e parë të madh me aplikacionin e videove të shkurtra Doyin në Kinë. Një vit më vonë e ka lansuar “TikTok”-un, një version ndërkombëtar. Ky aplikacion ishte bllokuar në Kinë, mirëpo më pas është përdorur prej miliarda përdoruesve brenda pesë vjetëve. Ndonëse themeluesit zotërojnë vetëm 20 për qind të aksioneve të kompanisë “Byte Dance”, ata janë kontrolluesit kryesorë të saj. Rreth 60 për qind është në

pronësi në investitorëve institucionalë, përfshirë kompanitë e mëdha amerikane sikurse General Atlantic, Susquehanna and Sequoia Capital. Tre prej pesë anëtarëve të bordit janë amerikanë. Mirëpo, rritja e pushtetit të Pekinit në kompanitë private në vitet e fundit e shqetëson ShBA-në se sa ka kontroll Partia Komuniste e Kinës mbi Byte Dance dhe të dhënat që ka. Kina i ka hedhur poshtë këto shqetësime, duke i konsideruar paranojë amerikane.

Pas shkarkimit nga kryetari i Preshevës, Shqiprim Arifi thotë se nuk do të merret më me politikë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRESHEVË, 21 PRILL - Shqiprim Arifi tha se autoritetet në Serbi "në mënyrë arbitrare", në mesnatë, e kanë shkarkuar nga pozita e kryetarit të komunës së Preshevës. Ndërkaq, në vendimin e qeverisë serbe të 18 prillit thuhet, pa dhënë arsye, se është shpërndarë Kuvendi Komunal i Preshevës dhe është paralajmëruar krijimi i një organi të përkohshëm.

Arifi më 20 prill tha se është krijuar një organ i përkohshëm deri në zgjedhjet e ardhshme dhe në krye të Preshevës - komunë në jug të Serbisë, e banuar me shumicë shqiptare është vendosur Ragmi Mustafa. "Ka disa kohë që [presidenti serb Aleksandar] Vuçiq kërcënon publikisht shqiptarët e Luginës së Preshevës. Shkarkimi i dhunshëm imi, mesnatën e

mbrëmshme, pa asnjë procedurë ligjore dhe asnjë njoftim, ndodh menjëherë pas kërcënimit të fundit publik të Vuçiqit në këtë javë dhe 24 orë pasi u dënova nga Gjykata serbe për vendosjen e flamurit kombëtar shqiptar më 28 nëntor", shkroi Arifi në llogarinë e tij në "Facebook".

Arifi dhe partia e tij Alternativa për Ndryshim u dënuan nga një gjykatë në Vranjë të Serbisë me një gjobë prej 470 eurosh për vendosjen e flamurit të Shqipërisë në zyrat e partisë në Bujanoc më 27 nëntor 2022, një ditë para përvjetorit të pavarësisë së Shqipërisë.

Në vendim u tha se ai dhe partia e tij u gjetën fajtorë pasi në orën 21:05 të 27 nëntorit të vitit 2022 "kanë shfaqur flamurin e një shteti të huaj, Shqipërisë, pa e shfaqur flamurin e Serbisë". Me këtë, tha gjykata, Arifi dhe partia e tij kanë



shkelur ligjin që rregullon përdorimin e flamurit dhe simboleve të tjera kombëtare të Serbisë.

Arifi për shkarkimin e tij fajësoi edhe eksponentë politikë shqiptarë në Luginë të Preshevës - Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, të cilët i akuzoi se janë bërë "vegël e lehtë për Vuçiqin dhe Serbinë për

ta realizuar agjendën e tij antishqiptare në Luginë të Preshevës". "Me këtë shkarkim të dhunshëm nga regjimi serb i jap fund politikës aktive në Luginë të Preshevës, por në anën tjetër dhe njëherë më shumë më ka motivuar që luftën ndaj padrejtësisë, diskriminimit, pasivizimit dhe luftën për të drejta

elementare dhe avokimin e të drejtave të popullit tim, për shqiptarët autokton të këtyre trojeve, ta ngriti në një nivel më të lartë!", ka pohuar ai.

Ndryshe, për shkak të mosmarrëveshjeve mes partive shqiptare politike, tash e sa vjet në Preshevë ka pasur jostabilitet politik në pushtetin lokal.

Presheva është një prej tri komunave në jug të Serbisë, ku popullsia shumicë është shqiptare.

Shqiptarët në Serbi janë pakicat e katërt kombëtare, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2022. Në këtë shtet jetojnë 61 687 shqiptarë.

Partitë politike dhe banorët shqiptarë shpesh janë ankuar se autoritetet serbe po tentojnë ta ulin numrin e shqiptarëve që jetojnë në Serbi përmes pasivizimit të adresave të tyre.

PDK-ja angazhon potencialin profesional të diasporës



PRISHTINË, 21 PRILL - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka mirëpritur aderimet e disa të rinjve të suksesshëm në mërgatë që i janë bashkuar PDK-së. "Eron Muhaxheri, master në administrim digjital të biznesit, i flet tri gjuhë. Arlind Kuçica, i diplomuar në shkencë, i flet katër gjuhë. Dhe Drin Çeku, master në ndërmarrësi dhe menaxhment, i flet pesë gjuhë", ka treguar kreu i PDK-së gjatë prezantimit të tyre. Kryetari i PDK-së tha se këta të

rinj kanë përvoja dhe interesime të ndryshme nga biznesi, financat, filozofia, marketingu digjital, inovacioni e inteligjenca artificiale por, siç tha ai, një e kanë të përbashkët: dëshirën për të kontribuar në Kosovë.

"Këta tre djem janë ndër anëtarët më të rinj të Partisë Demokratike të Kosovës në mërgatë, të cilët, bashkë me kryetarin e degës sonë në Zvicër, Ragip Xhakën, i mirëpritëm në selinë qendrore të PDK-së", tha ai.

Sipas Krasniqit, Drini, Arlindi dhe

Eroni janë shembuj të suksesit dhe progresit të gjeneratës së re të mërgimtarëve tanë nëpër të gjithë botën e që, megjithatë, jetojnë me mall e dashuri për Kosovën. "PDK u ka krijuar hapësirën, e të rinj e të reja si këta, po i bashkohen çdo ditë platformës tonë politike, që përgatitjen dhe shkathtësitë e tyre t'i vënë në shërbim të atdheut tonë të përbashkët: Kosovës! I lumtur sa s'ka - e pafundësisht krenar me rininë tonë në mërgatë", tha Krasniqi.

Me nderime të larta shtetërore i jepet lamtumira e fundit ish-komandantit të UÇK-së, Gani Imerit



VUSHTRRI, 21 PRILL - Me nderime të larta shtetërore, të dielën, në varrezat e fshatit në Dumnice të Epërme të Vushtrrisë, i është dhënë lamtumira e fundit ish-komandantit të UÇK-së, Gani Imerit. Pas homazheve dhe akademisë përkujtimore u tha se sakrificat, guximi dhe kontributi i Ganiut do të jetojnë përjetësisht në historinë më të lavdishme të

shtetit dhe popullit tonë. Kryetari i komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, në emër të institucioneve komunale i shprehi ngushëllimet më të thella familjes së komandantit, Gani Imeri, dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të UÇK-së. "Komandant i Batalionit IV të Brigadës 141 në Zonën Operative të Shalës, Gani Imeri tregoi shembullin e një

burrështetasi të guximshëm që para lirisë së atdheut nuk vendoste asgjë tjetër", ka thënë kryetari Idrizi.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se lajmi për vdekjen e ish-komandantit të UÇK-së në Zonën Operative të Shalës, Gani Imeri, ishte i trishtë. "Para, gjatë dhe pas luftës Ganiu dhe familja e tij Imeri nga Dumnica e Epërme

dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në çlirimin, forcimin dhe shtetndërtimin e vendit tonë. Ai vinte nga një familje atdhetare dhe një të tillë la mbresa. Vepra dhe jeta e tij do të jenë frymëzim dhe shembull për gjeneratat që la pas. Ngushëllimet më të thella familjes Imeri, bashkëluftëtarëve të tij, miqve dhe gjithë qytetarëve të Vushtrrisë!", ka

thënë lideri i PDK-së, Memli Krasniqi.

Gani Imeri ishte komandant i Batalionit IV të Brigadës 141, Zona Operative e Shalës e UÇK-së. Ai ishte shembull i një luftëtari në luftën e UÇK-së, i një humanisti dhe udhëheqësi të palodhshëm në shërbim të qytetarëve dhe të atdheut. Emri i tij la gjurmë në historinë më të re të Kosovës.





Dështon iniciativa për largimin e kryetarëve shqiptarë në veri

Në katër komunat e banuara me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, të dielën është votuar për largimin e katër kryetarëve shqiptarë. Megjithatë, kjo iniciativë ka dështuar pasi në këtë proces nuk kanë marrë pjesë 50 për qind plus 1 e votuesve. Në total kanë votuar 253 persona. Lista Serbe i ftoi votuesit për bojkot me arsyetimin se listat e votuesve “nuk e pasqyrojnë gjendjen reale në terren”, duke thënë se numri i shqiptarëve në listat e votuesve “ishte rritur”

EPOKA ERE**Mal QORRAJ**

PRISHTINE, 21 PRILL - Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka thënë të dielën se iniciativa për largimin e kryetarëve të komunave veriore në Kosovë ka dështuar pasi në këtë proces nuk kanë marrë pjesë 50 për qind plus 1 e votuesve. Sipas tij, në total kanë votuar 253 persona.

Në Leposaviq kanë votuar 124 votues apo 0.91 për qind e shifrës totale, në Zubin Potok 18 votues apo 0.26 për qind, në Zveçan asnjë votues, ndërsa në Mitrovicë të Veriut 111 votues apo 0.59 për qind.

Të gjitha qendrat e votimit, 23 sosh, u mbyllën të dielën në orën 19:00.

Një vit më parë shqiptarët u bënë kryetarë të komunave në veri të vendit pasi Beogradi u kërkoi serbëve në Kosovë t'i

bojkotonin zgjedhjet e 23 prillit 2023, gjë që rezultoi me zgjedhjen e katër kryetarëve shqiptarë - fitues me pjesëmarrjen e vetëm 3 % të votuesve. Udhëheqjen e Leposaviqit e mori Lulzim Hetemi nga LV-ja, atë të Zubin Potokut Izmir Zeqiri nga PDK-ja, udhëheqjen e Zveçanit e mori Ilir Peci nga PDK-ja, ndërsa në krye të Mitrovicës së Veriut erdhi Erden Atiq nga LV-ja.

Partia dominuese në veri të Kosovës, Lista Serbe, e kontrolluar nga Beogradi, u bëri thirrje serbëve të mos marrin pjesë në këtë votim, me arsyetimin se ai është organizuar në atë mënyrë që t'ua mundësojë kryetarëve aktualë të qëndrojnë në udhëheqje të këtyre komunave deri në fund të mandatit.

Për t'u bërë i mundshëm largimi i kryetarëve aktualë të katër komunave veriore dhe organizimi i zgjedhjeve të reja në

veri, më shumë se 50 % e atyre që kanë të drejtë të votojnë duhet të merrnin pjesë. Nëse votimi nuk do të bojkotohej, mendohej se do t'ua hapte rrugën zgjedhjeve të reja lokale atje, të cilat do të duhej t'i kontribuonin shtensionimit të situatës e cila pas zgjedhjeve lokale të vitit 2023 u përshkallëzua deri në dhunë. Për këto votime në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq të drejtë vote kishin 46 556 persona apo 1 461 votues më shumë krahasuar me zgjedhjet lokale të mbajtura më 23 prill 2023, kur u zgjodhën kryetarët shqiptarë.

Demokracia në Veprim ka vëzhguar procesin e votimit për ose kundër largimit të kryetarëve të katër komunave veriore të vendit në të gjitha qendrat e votimit që nga hapja e tyre në orën 07:00 të mëngjesit. Sipas vëzhgueseve, të gjitha qendrat e votimit janë mbyllur me kohë, pra në orën 19:00, ndërsa nuk

është raportuar për asnjë rast ku qytetarët kanë qenë duke pritur në radhë për të votuar.

Procesi i votimit gjatë gjithë ditës është karakterizuar me mungesë të theksuar të interesimit nga qytetarët për të marrë pjesë në votim pavarësisht se në muajin janar mbi 20 % të qytetarëve me të drejtë vote kishin nënshkruar peticionin për largimin e kryetarëve në katër komunat e veriut të Kosovës.

DnV vlerëson se kjo ishte një mundësi e humbur për qytetarët që ta shprehnin vullnetin e tyre për t'u hapur rrugë zgjedhjeve për kryetarë të rinj të komunave të cilët do të gëzonin legjitimitet përfaqësues. Hedhja e votës është instrumenti i parë demokratik përmes së cilës qytetari krijon lidhshmëri dhe pjesëmarrje në politikat lokale e më pas edhe ka mundësi të kërkojë llogari nga të zgjedhurit. Sipas Demokracisë në Veprim, kushtet teknike nëpër disa Qendra të Votimit, përkatësisht vendvotime, nuk kanë plotësuar standardet e procesit të votimit. Vlen të përmendet përzgjedhja joadekuate e objekteve të cilat kanë luajtur rolin e Qendrave të Votimit, pasuar nga grumbullimi i disa vendvotimeve në një hapësirë të vetme, vendosja e vedvotimeve në katet e larta të ndërtesave komunale, improvizimi i zyrave ose

dhomave të ngushta si vendvotime si dhe mungesa e ngrohjes apo ndriçimit në vendvotimet e organizuara në kontejnerë. Megjithatë, sipas DnV-së, ky proces ka rrjedhë në mënyrë të qetë dhe pa ndonjë incident.

Krasniqi: Lista Serbe dëshiron të ketë monopol mbi politikën e serbëve në Kosovë

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, tha se procesi i votimit në katër komunat në veri të Kosovës, lidhur me shkarkimin e kryetarëve shqiptarë, ka shkuar “qetë dhe mirë”. Në një deklaram për gazetarët nga Leposaviqi, ku vizitoi qendrat e votimit, Krasniqi u ndal edhe te bojkotimi i procesit të votimit nga Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit, të cilën e akuzoi se dëshiron të ketë “monopol” mbi politikën e komunitetit serb në Kosovë.

“Lista Serbe dëshiron ta ketë monopolin mbi politikën e serbëve në Kosovë. Ata i shohin institucionet vetëm për vete dhe jo për qytetarët. Ata vazhdojnë t'i kenë ulëset e rezervuara për komunitetin serb në Kuvendin e Kosovës dhe mos t'i

Mbahet takimi i Komisionit të Përgjithshëm për Drejtësi, Çështje të Brendshme dhe Siguri i Asamblesë Parlamentare

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 PRILL - Në Kuvendin e Republikës së Kosovës vazhduan punimet e Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (AP e PBEJL-së), me temën "Sfidat në fushën e sigurisë në vendet e Evropës Juglindore: pasojat politike dhe të sigurisë si një sfidë për paqe dhe stabilitet në rajon".

Punimet e Asamblesë i zhvilloi Komisioni i Përgjithshëm për Drejtësi, Çështje të Brendshme dhe Siguri, që zyrtarisht i hapi kryetari i këtij komisioni, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Mefail Bajqinovci, i cili fillimisht u uroi mirëseardhje anëtarëve të kësaj asambleje. Sesionit punues i parapriu fjalimi i ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Ejup Maqedonci.

Ministri Maqedonci, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, theksoi rëndësinë e një takimi të tillë me diskutime përmbajtjesore për çështjet që përfshijnë

vendet e Ballkanit Perëndimor. Duke iu adresuar çështjeve konfliktuale të agresionit rus në Ukrainë, i pari i Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës tha se edhe Ballkani ende ka gjendje jostabile nisur nga tensionet mes Serbisë dhe Kosovës dhe çështjeve të tjera që ndërlidhen me sigurinë dhe mbrojtjen.

Ministri Maqedonci, po ashtu, theksoi se është në interes të përgjithshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor gjetja e mekanizmave për integrim evropian përmes diplomacisë ndërparlamentare dhe bashkëpunimit evropian.

Ministri Maqedonci foli edhe lidhur me përpjekjet ruse për destabilizim të rajonit, përfshirë edhe nëpërmjet lajmeve të rrejshme. Më pas, punimet vazhduan me prezantimet e raporteve nga anëtarët e kësaj asambleje.

Kordinatori i EJL dhe analisti i lartë i politikave ekonomike, Arslan Umur Ergezer, gjatë prezantimit të barometrit të sigurisë të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndër të tjera, foli edhe për çështjen e

korupsionit. Tutje, duke folur për të gjeturat e raportit për sa i përket migrimit të qytetarëve, deputeti Umur Ergezer tha se një numër i madh i qytetarëve nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë të interesuar të migrojnë për në vende të tjera. "Mbi 50 për qind e të rinjve në vendet tona dëshirojnë të largohen nga vendet e tyre", tha Umur Ergezer, duke shtuar se përqindja shkon edhe më lart kur është në pyetje siguria për të ardhmen ekonomike të qytetarëve.

Migrimi dhe siguria ai tha se janë të ndërlidhura mes vete, kështu që lufta në Ukrainë, përkatësisht vazhdimi i saj, krijon edhe më shumë ndenjën e pasigurisë të qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Kurse përgjatë prezantimit të gjetjeve të raportit "Sfidat në fushën e sigurisë në vendet e Evropës Juglindore: pasojat politike dhe të sigurisë si një sfidë për paqe dhe stabilitet në rajon", kryetari i Komisionit të Përgjithshëm për Drejtësi, Çështje të Brendshme dhe

Siguri, deputeti Bajqinovci, tha se fokusi kryesor është mbi ndikimin e kërcënimeve të jashtme ndaj paqes, sigurisë dhe stabilitetit e rajonit të Evropës Juglindore. "Raporti vë në dukje se zhvillimet e vitit 2023 treguan përpjekje për përqendrimin e stabilitetit në rajonin e Evropës Juglindore. Prishtina dhe Sarajeva shënojnë raste serioze të tensioneve, të cilat mund të çojnë drejt pasigurive të mëdha si pasojë e tensioneve dhe kërcënimeve të jashtme", tha Bajqinovci. Në këtë kontekst, Bajqinovci shtoi se kërcënimet në rritje të sigurisë dhe tensionet në Prishtinë, për shkak të përpjekjeve të Beogradit për destabilizim të komunave veriore të Kosovës dhe përpjekjeve të etnitetit të Republikës Serbe për shpërbërje nga Sarajeva, janë aspekte të veçanta që ky raport thekson. Po ashtu, deputeti Bajqinovci tha se sipas këtij raporti edhe inteligjenca amerikane parashikon rritjen e tensioneve etnike në rajon, të cilat mund të shfrytëzohen nga liderët nacionalistë për avantazhe

politike dhe për ta penguar integrimin në BE dhe në NATO. "Si përfundim, në dritën e raportit, është e qartë se pushtimi ushtarak rus në Ukrainë ka ngritur sfida të rëndësishme në fushën e sigurisë dhe politikës, duke rrezikuar edhe paqen dhe stabilitetin e disa vendeve anëtare të SEECP-së", theksoi deputeti Bajqinovci, duke shtuar se, pavarësisht nga kërcënimet e jashtme, Kosova është e interesuar për fqinjësi të mirë, respekt dhe bashkëpunim reciprok.

Pas përfundimit të debatit nuk pati kuorum për vendimmarrje për miratimin e draft-raportit dhe draft-rezolutës, pasi që sallën e lëshoi deputeti nga Republika e Maqedonisë Veriore.

Në punimet e Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (AP e PBEJL-së), të cilat u përmbyllën të dielën, morën pjesë deputetë nga Kosova, Shqipëria, Turqia, Kroacia, Bullgaria, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina.



përfaqësojnë interesat e qytetarëve, mirëpo t'i marrin pagat e Kuvendit të Kosovës. Tashmë qytetarët, edhe me votim, deklarojnë nëse janë për largimin e kryetarëve ose jo", tha Krasniqi. Ai tha se institucionet kanë realizuar të gjitha obligimet për mbajtjen e këtij procesi, duke nisur nga nxjerrja e udhëzimit administrativ në shtator, e deri tek organizimi i votimit më 21 prill.

Osmani: Kosova organizoi zgjedhje në veri dhe plotësoi kushtet e BE-së, të hiqen masat e padrejta menjëherë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar pasi janë mbyllur kutitë e votimeve në veri. Në "Facebook", Osmani tha

se Kosova ua dha qytetarëve të komunave të veriut mundësinë t'i largojnë kryetarët aktualë dhe t'i zgjedhin kryetarët e rinj. "Kosova u dha qytetarëve të komunave të veriut mundësinë t'i largojnë kryetarët aktualë dhe t'i zgjedhin kryetarët e rinj. Qytetarët në masë të madhe nuk e shfrytëzuan këtë mundësi. Për fat të keq, kjo kryesisht ndodhi për shkak të presionit të Beogradit, të

ekzekutuar nga Lista Serbe dhe strukturat ilegale kriminale. Edhe njëherë, Serbia kreu ndërhyrje të paligjshme në një proces zgjedhor të një shteti tjetër. Edhe njëherë, Vuçiqi shkeli fjalën që ua kishte dhënë partnerëve ndërkombëtarë. Por, Kosova sërish dëshmoi maturi, organizim e respektim të plotë të ligjeve e Kushtetutës, duke u ofruar të gjitha komuniteteve, pa dallim, mundësinë që ata të

zgjedhin vetë se kush dëshirojnë t'i përfaqësojë. E falënderoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, institucionet tona të sigurisë, si dhe partnerët tanë për punën, përkushtimin dhe bashkëpunimin. Me organizimin e procesit të sotëm, Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara nga BE-ja. Masat e padrejta kundër Kosovës duhet të hiqen menjëherë", ka thënë Osmani.

Në veri konfiskohen dy armë të gjata, një elektroshok dhe një sasi e municionit

PRISHTINË, 21 PRILL - Policia e Kosovës të dielën rreth orës 10:30, si rezultat i angazhimeve, ka pranuar një informacion se në Zveçanin e vogël, në një shtëpi, dyshohet se ka armë ilegale. Sipas detyrës zyrtare është njoftuar prokurori

kujdestar, me autorizim të të cilit zyrtarët policorë, sipas procedurave të parapara, kanë realizuar një operacion të kontrollit të një shtëpie, në tavanin e së cilës janë gjetur dhe konfiskuar dy armë zjarri AK-47, disa karikatorë, një sasi e

municionit dhe një elektroshok. Policia e Kosovës ka informacione lidhur me personin e dyshuar mashkull serb të cilit i përket shtëpia e banimit e i cili dyshohet se gjendet në Serbi.

Vlen të potencohet se ky rast nuk ndërlidhet me procesin e votimit, për apo kundër largimit nga funksioni i kryetarëve të komunave të Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit.



Kurti me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave të Veteranëve diskutojnë për nevojën e nismës ligjore për mbrojtjen e vlerave të luftës

PRISHTINË, 21 PRILL - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe këshilltarët politikë, Aziz Bici dhe Tea Blakaj-Hoxha, priti në takim kryetarin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Veteranëve, Xhevdet Qeriqi dhe Hyzri Musliun, Naim Gashin dhe Safedin Zukën, veteranë dhe invalidë të luftës. Së bashku diskutuan nevojën e nismës ligjore për mbrojtjen e vlerave të luftës. Përtej rregullimit të kompensimit të plotë të shpenzimeve lidhur me protezat e invalidëve të luftës, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, u përmend edhe buxheti i rritur për barnat në vlerën prej 60 milionësh dhe zbatimi i Ligjit të ri për Çmimin e Barnave. Kryeministri Kurti theksoi përkushtimin dhe punën e

vazhdueshme në adresimin e nevojave dhe mbrojtjes së të drejtave të veteranëve dhe invalidëve të luftës. Ndaj këtij takimi ka reaguar ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVL-UÇK-së, Faton Klinaku. "Së pari: Mbrojtjen e të drejtave të veteranëve të luftës së UÇK-së nuk e bën z. Xhevdet Qeriqi, por Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, e ai është vetëm kryetar i Degës së Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së në Fushë-Kosovë. Së dyti: Çështja e protezave për invalidët e luftës së UÇK-së është rregulluar pas takimit tonë vitin e kaluar me presidenten dhe insistimit të saj që ato nëse nuk i rregullon shteti, t'i sjell nga shteti i Katarit. Së treti: Albin Kurti bën vetëm fushata elektorale, por shokët tanë nuk duhet të bien pre e kësaj", ka thënë Klinaku.



Gratë e Kosovës shkruajnë histori, sërish shteti ynë prek majat e suksesit botëror në art

PRISHTINË, 21 PRILL - Pavijoni i Republikës së Kosovës merr mirënjohje të veçantë për Përfaqësim Shtetëror në edicionin e 60 të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit në Bienalen e Venecias. Kjo është hera e parë që shteti ynë merr mirënjohje të tillë që nga pjesëmarrja e parë në vitin 2013. Kështu ka bërë me dije në "Facebook" ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku. "Një arritje e jashtëzakonshme e artistes Doruntina Kastrati, e cila e vendosi Kosovën në mesin e më të mirëve në konkurrencë me mbi 80 shtete nga e gjithë bota. Instalacioni skulpturor "Heshtjet Kumbuese të Metalit dhe



Lëkurës" me kuratore Erëmirë Krasniqi dhe komisionere Hana Halilaj, ka rrënjët te përvojat e grave që kanë punuar në një fabrikë llokumesh në Prizren, në vendlindjen e artistes. Përgëzime për gjithë ekipin, përgëzime për Kosovën", ka shkruar ministri Çeku.

Abdixhiku: Themelimi i nëndegëve të reja në mërgatë, prioritet i angazhimit tonë partiak

PRISHTINË, 21 PRILL - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se themelimi i nëndegëve të reja në mërgatë mbetet prioritet i angazhimit të tyre partiak. "Nga 4 nëndegë aktive sa i kishim 3 vite më parë, sot i kemi themeluar e riaktivizuar plot 58 sosh. Nga takimi i punës në Mynih për themelimin e nëndegëve të reja në Gjermani, ftoj secilin të djathtë, në çdo anë, t'i bashkohet nismës sonë në Mërgatë. Kjo shtëpi e madhe e demokracisë është e hapur për çdo bashkëmendimtarë e bashkatdhetarë, që aktivitetin e aksionin politik e shoh si formë të një ideali jetësor. Ekipi politik për mërgatë, Anton Quni, Sokol



Haliti, Armend Zemaj, Jehona Lushaku Sadriu, Visar Azemi, Shkumbin Gashi e plot të tjerë, po bëjnë punë të jashtëzakonshme. Shtrirja jonë politike mbetet angazhimi parësor i tyre! Le ta bëjmë 'Rrugën e Re' bashkë!", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Liderët e koalicionit VLEN takojnë Kurtin: Ndryshimi po vjen

PRISHTINË, 21 PRILL - Liderët e koalicionit VLEN që garojnë në zgjedhje në Maqedoninë e Veriut janë takuar të dielën me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Lëvizjes Demokratike, Izet Mexhiti, i cili ka thënë: "Ndryshimi po vjen, fitorja do të jetë e thellë! Sapo u takuam në

Prishtinë dhe morëm mbështetje të pazezervë nga kryeministri Albin Kurti, kryeministri që VLEN, kundër korrupsionit, kundër Ballkanit të Hapur,

kundër regjimit të vjetër. Ndryshimi po vjen, fitorja do të jetë e thellë!", ka shkruar në "Facebook", Izet Mexhiti, kryetar i Lëvizjes Demokratike.



Për herë të parë Kosova merr vlerësim kreditor

PRISHTINË, 21 PRILL - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës bëri me dije se Agjencia Ndërkombëtare "Fitch Ratings" ka dhënë vlerësim kreditor 'BB' për Kosovën.

Vlerësimi kreditor mat aftësinë e qeverisë për t'i shlyer borxhet e saj. "Ky vlerësim kreditor do të shërbejë si një pasaportë për Kosovën për çdo investitor të huaj që është i interesuar të shohë se a ia vlen të investohet në vendin tonë. Po ashtu, do të ndikojë në uljen e kostos së financimit që, rrjedhimisht, do të ketë mundësi më tepër për financim për bizneset tona", tha ministri i Financave, Hekuran Murati, në një videodeklarate të publikuar në "Facebook".

Kjo është hera e parë që është publikuar një vlerësim kreditor për Kosovën.

Sipas Ministrisë së Financave, kjo "merr parasysh qëndrueshmërinë e politikave fiskale, borxhin publik, deficitin, rritjen ekonomike, sektorin bankar dhe cilësinë e qeverisjes, ndër të tjera". Në vlerësimin kreditor merren parasysh shumë faktorë ekonomikë, financiarë,



institucionalë dhe politikë, andaj ai tregon nëse shteti ka qëndrueshmëri ekonomike dhe financiare. "Ky vlerësim kreditor e vendos Kosovën në hartën

botërore të shteteve serioze me politika të qëndrueshme, duke forcuar kështu edhe më tej pozicionin e vendit dhe njohjen në arenën ndërkombëtare", tha

Ministria e Financave. Vlerësimi Kreditor për Kosovën është mbështetur nga Agjencia e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Shkalla e vlerësimit të kredive sovraane: Ku qëndron rajoni?

Shkalla e vlerësimit të kredive nga Fitch bëhet duke përdorur kategoritë: AAA (Cilësia më e lartë e kredisë), AA (Cilësi shumë e lartë e kredisë), A (Cilësi e lartë e kredisë); BBB (Cilësi e mirë e kredisë), BB (Spekulative), B (Shumë spekulative), CCC (Rrezik i konsiderueshëm i kredisë), CC (Nivel shumë i lartë i rrezikut të kredisë), C (Pranë mospagesës), RD (Mospagim i kufizuar) dhe D (mospagim).

Një + dhe - shitesë nga kategoritë AA deri në CCC nënkupton dallimet relative të mundësisë së mospagimit ose rikuperimit.

Shqipëria ka nivelin e njëjtë sikurse Kosova, me vlerësim kreditor BB-, Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë vlerësimin BB+, Bosnjë-Hercegovina ka B+, Kroacia ka BBB+, Gjermani AAA, Italia BBB, Greqia BBB-, kurse Pakistani CCC+.

Hoti ngre alarmin për mungesë të investimeve kapitale, kërkon rishikim të politikave fiskale



PRISHTINË, 21 PRILL - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka theksuar se në qeverinë Kurti janë përgjysmuar investimet kapitale në vend. Ndërsa sa i përket Ligjit për Pagën Minimale që nga ana e qeverisë u vlerësua si i suksesshëm, Hoti vlerëson se është dashur të rishikohet kjo pagë, në mënyrë që, sipas tij, të përshtatet me inflacionin që ka mbizotëruar në vend vitet e fundit.

Paga aktuale minimale në Kosovë, për të punësuarit e moshës mbi 35-vjeçare është 170 euro, ndërsa të punësuarit e moshës nën 35 vjet kanë pagën minimale në vlerë prej 130

eurosh.

Deputeti i LDK-së, në një intervistë për "KosovaPress", ka kritikuar qeverinë aktuale për mungesë të politikave fiskale. "Për fat të mirë një ligj është në fuqi, i cili e përcakton formulën se si përcaktohet paga minimale. Por këta e sollën në Kuvend një ligj pa asnjë konsultim publik paraprakisht me grupet që ndikohen nga paga minimale dhe u krijua një situatë absurde në komunikimin publik në këtë drejtim, dhe gati janë në fund të mandatit pa pasur mundësi të bëhet lëvizje në pagën minimale. Është fakt se në të kaluarën kanë qenë vite pa u prekur paga

minimale, por nuk ka pasur normë të madhe të inflacionit në qeveritë e kaluara. Gjatë kësaj qeverie ka pasur inflacion të lartë dhe ka qenë e kuptueshme që të rishikohet edhe paga minimale, por edhe të ardhurat e grupeve të caktuara të qytetarëve", thotë Hoti.

Kjo qeveri, sipas Hotit, ngecje pati edhe në investimin e projekteve kapitale.

Teksa thotë se janë përgjysmuar investimet kapitale në Kosovë të nivelit qendror, ai shton se të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve kapitale shkon për avance për investime kapitale.

Guvernatori Ismaili takohet me anëtarin e bordit ekzekutiv të BQE-së, Piero Cipollone, flasin për bashkëpunimin e dyanshëm

PRISHTINË, 21 PRILL - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, ka zhvilluar një takim me Piero Cipollone, anëtar i bordit ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), gjatë takimeve pranverore në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Uashington. Ky ishte takim përmblyllës i BQK-së me partnerët dhe palët ndërkombëtare.

Takimi ofroi një mundësi për të shkëmbyer pikëpamje mbi çështje të ndryshme të bashkëpunimit të ndërsjellë mes BQK-së dhe BQE-së. Guvernatori Ismaili e informoi Cipollonen për zhvillimet kryesore

brenda BQK-së, duke përfshirë përparimet në përgatitjet për integrimin dhe pajtueshmërinë me SEPA, si dhe çështjet e tjera të rëndësishme me të cilat përballet banka qendrore.

Gjithashtu, takimi u fokusua në diskutimet mbi eksplorimin e mundësive për adoptimin e zgjidhjeve nga BQK për pagesat e shpejta me qëllim të ndërlikohjes me TIPS, si dhe diskutime të vazhdueshme me vendet fqinje për gjetjen e zgjidhjeve optimale për rajonin.

Guvernatori Ismaili theksoi angazhimin e palëkundur të BQK-

së për ta avancuar dhe modernizuar sistemin e saj të pagesave, që do ta hapte rrugën për integrimin në infrastrukturën e tregut financiar të Bashkimit Evropian në përputhje me objektivat strategjike të BQK-së.

Këto angazhime pasqyruan përpjekjet e BQK-së për të nxitur partneritetet të forta me palët ndërkombëtare kyçe, duke avancuar misionin e institucionit për ta promovuar stabilitetin financiar dhe përfshirjen financiare, të cilat janë thelbësore për ta nxitur zhvillimin ekonomik në vend.



Barra naziste e familjes sime dhe dhimbja për Gazën

Nga: Eva LADIPO / *The Guardian* (Titulli original: *My family's past, and Germany's, weighs heavily upon me. And it's why I feel so strongly about Gaza*)
Përkthimi: *Telegrafi.com*

Zakonisht nuk flas për Walterin, për xhaxhain tim. Gjenerali Walter Warlimont, siç njihet zyrtarisht vëllai i gjyshit tim, ishte kreu i Departamentit të Mbrojtjes Kombëtare në komandën e lartë të Vermahtit – të forcave të armatosura të Gjermanisë naziste. Në zinxhirin komandues, vetëm dy persona ishin midis tij dhe Firerit. Walteri punoi aq ngushtë me Hitlerin sa që, në korrik të vitit 1944, u plagos në krah në atentatin e dështuar për vrasjen e tij. Urdhrat që nënshkroi gjatë kohës së luftës – kë do ta qëllonte për të vranë, si do të trajtoheshin të burgosurit – nënkuptonin se kishte qindra mijëra jetë në ndërgjegjen e vet. Jo se xhaxhai Walter ishte i vetmi në familje i cili e ndihmoi Rajhun e Tretë dhe Holokaustin. Gjyshërit nga ana e babait ishin shumë krenarë se ishin ndër anëtarët më të hershëm të partisë së Hitlerit. Gjyshi im nga ana e nënës – vëllai i Walterit – ishte kreu i një fabrike në Vjenë ku prodhoheshin sistemet e drejtimit për raketën V2 – fabrikë që kishte staf nga punëtorët skllëvër rusë dhe ukrainas.

Kurrë më parë nuk e kam ndier nevojën që të shkruaj për historinë time familjare. Por, jeta dhe krimet e Walterit tani ndihen si shumë të pakëndshme. Teksa shikoj se si ka lëvizur debati dhe diskutimi mbi luftën në Gazë, në Gjermani – në muajt pas sulmeve të tmerrshme të 7 tetorit – shqetësohem se tekta vazhdimisht thirremi në të kaluarën naziste, ne po i harrojmë disa mësimet vendimtare nga historia.

Mbështetja për Izraelin është e shenjtë në Gjermani. Kjo për një arsye të mirë. Është krejtësisht e natyrshme që Gjermania të ndihet e rënduar nga faji – kur është fjala për popullin hebraik; si shumica e gjermanëve, besoj se solidariteti me shtetin hebraik, i cili u krijua pas Holokaustit, është detyrim i shenjtë. Por, ndryshe nga shumëkush në vendin tim, nuk besoj se vetëm mbështetja për Izraelin e përmblush përgjegjësinë që na rëndon nga tmerrret e së kaluarës. Në vend të kësaj, kam frikë se për hir të dëshirës mbizotëruese për të qëndruar përkrah Izraelit – dëshirë që ka sjell Gjermaninë te një akuzë në Gjykatën



Ndërkombëtare të Drejtësisë, për ndihmë ndaj gjenocidit – ne pa dashje po i përsërisim i gabimet që janë bërë më parë. Po mësimi se jeta e të gjithë njerëzve ka vlerë të barabartë? Në kulmin e karrierës së xhaxhait Walter, Gjermania e ndau botën midis Übermenschën dhe Untermenschën – mes njerëzve superiorë dhe inferiorë. Rezultati i tmerrshëm i asaj ndarjeje duhej t'i shtynte gjermanët te njohja e kuptimit për rëndësinë e vlerësimit të të gjithë njerëzve si të barabartë – pavarësisht nga përkatësia racore, etnike apo fetare. E, megjithatë, tekta ndjek diskutimin e luftës në Lindjen e Mesme, dhe faktin me të cilin është pranuar numri i viktimave në Gazë, shpeshherë kam përshtypjen se ky mësim po harrohet.

Analiza nuk mund të ndihmojë më palestinezët të cilët kanë vdekur në Gazë. Por, mund të ndihmojë njerëzit të cilët jetojnë në vendin tim. Gjermania tashmë është komb multietnik, multifetar. Vlerësohet se në vendin tonë ka rreth 200 mijë njerëz me origjinë palestineze dhe miliona njerëz të tjerë të ardhur nga gjithë Lindja e Mesme. Kur shohin se si diskutohet lufta në Gazë, shumë prej tyre e perceptojnë botën në të cilën jeta e hebrenjve duket shumë më e rëndësishme sesa ajo e arabëve. Duket se lufta po lejon që pikëpamja e ndrydhur prej kohësh, për botën, po rishfaqet në Gjermaninë në të cilën ka kultura superiore “perëndimore”, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër inferiore – më

pak të sofistikuara. Debati është i mbytur jo vetëm për protestuesit palestinezë apo myslimanë, por për të gjithë. Mbizotëron klima mbrojtëse në të cilën konceptet e thjeshtuara të së mirës dhe së keqes janë më të privileguara sesa analizat e nuancuara. Kritikët e fushatës ushtarake të Izraelit, në mënyrë të vazhdueshme etiketohen si antisemitë.

Kur Masha Gessen e shkroi një ese për New Yorker, për dogmën agresive të qëndrimit pro-izraelit të Gjermanisë, shumë nga mediat gjermane reagon me zemërim. Eseja u reduktua në mënyrën që tërheq vëmendjen përmes krahasimit që shfaqet aty – midis Gazës dhe getove të epokës naziste – e të cilin kritikët gjermanë e përdorën për ta akuzuar autorin për minimizimin e Holokaustit. Regjisori izraelit Yuval Abraham, u përball me zemërim të ngjashëm pasi e dënoi trajtimin palestinezëve nga Izraeli dhe pasi bëri thirrje për armëpushim – në një fjalim në Festivalin e Filmit në Berlin. Shumë zëra të tjerë kritikë, veçanërisht në arte dhe në akademi, janë të paftuar, të mohuar, dhe pothuajse brenda natës e shohin veten si persona non grata.

Përveçse jam mbesa e një prej gjeneralëve të Hitlerit, jam edhe gazetare në Londër. Raportimi për luftën, në Britani, më ka bërë më të lirë dhe më të matur në aspektin historik – sesa në Gjermani. Menjëherë pas masakrës së Hamasit, zëvendëskancelari gjerman, Robert Habeck, u lavdërua gjerësisht për paralajmërimin se “kontekstualizimi” i mizorive

mund të çonte në “relativizimin” e tyre. Ngjarjet fatale që çuan në themelimin shpengues të Izraelit dhe në tragjedinë e Nakbasë palestineze, të cilat ndriçohen dhe diskutohen në botën anglofone, debatohen shumë më me ndrojtje në Gjermani, thujse vështrimi më i saktë mund të minojë moralin dhe sigurinë për të qenë në “anën” e drejtë.

E, megjithatë, mendimi i tillë i thjesht duket se po e çon vendin tim në harresën e një mësimi tjetër të epokës naziste: rrezikun për t'u bërë pre e fanatikëve të djathtë. Nuk kam dyshim se qëllimet e mira – të nxitura nga pendesa – e ngulitën mbështetjen e pakushtëzuar gjermane për Izraelin. Por, në dëshirën tonë për ta pikturuar botën bardhezi – me rolin e viktimës të rezervuar për izraelitët, të cilët shihen si perëndimorë, dhe rolin e autorëve e krimin të caktuar për arabët të cilën shihen si të tjerët – e gjejmë veten në një linjë të çoroditur të autoritarëve: me qeverinë nacionaliste të djathtë të Benjamin Netanyahu, me nacionalistët e bardhë në ShBA dhe me partinë e ekstremit të djathtë AfD në Gjermani. Mësimi i fundit – dhe ndoshta më i sakti – të cilin shumë gjermanë duket se po e ndrydhin, rrjedh nga përvoja jonë e jashtëzakonshme e pasluftës. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas mizorive shekullore, në Evropë u përmbys rrethi vicioz i hakmarrjes. Me të vërtetë ishte historike, nga e cila autorët nazistë përfituan më shumë se kushdo tjetër. Shikojeni familjen time: për të gjitha krimet e veta, xhaxhai

Walter nuk u përball me dënimin me vdekje. Në vend të kësaj, pas gjashtë vjetëve iu hoq dënimi i përjetshëm – i caktuar ndaj xhaxhait tim në gjyqet e Nurembergut – dhe ai u lirua në vitin 1954. Vdiq në vitet 1970 si burrë i pasur dhe i respektuar, në brigjet e një prej liqeneve më të bukura të Bavarisë. Vëllai i tij, gjyshi im Paul Warlimont, u dënua me vetëm dy vjet burg për keqtrajtimin e punëtorëve të fabrikës. Më vonë iu dha Urdhri i Meritës i Gjermanisë. Gjyshërve të mi nga ana e babait, nazistëve shumë të hershëm, gjithashtu iu ofrua jeta e pasur dhe e lirë e pasluftës. Mëshira e dhënë për të gjithë të parët e mi, ashiqare nuk ishte në shërbim të drejtësisë. Por, shërbeu për interesat e paqes.

Shkurtimisht, gjatë tetë dekadave të fundit, Evropa e pasluftës ka përparuar falë vullnetit të jashtëzakonshëm të armiqve të Gjermanisë për t'i falur krimet e saj dhe për të lejuar që dëshira për pajtim të mposht dëshirën për drejtësi. Kjo përvojë duhet të na obligojë. Duhet t'i bëjë gjermanët, çdo herë dhe përgjithmonë, kundërshtarë të hakmarrjes dhe të ndëshkimit, qoftë nga palestinezët apo nga izraelitët. Nuk duhet t'i ndezim flakët në Lindjen e Mesme, duke u përkushtuar ndaj një komuniteti të rrethuar, kundër një tjetri, e lëre më duke eksportuar armë për qeverinë e Netanyahu dhe duke e mbështetur atë në Kombet e Bashkuara. Në vend të kësaj, duhet të flasim me përlulësi për mrekullitë që mund sjell heqja dorë nga hakmarrja. Ia kemi borxh historisë sonë.

/Telegrafi/

Rileximi i mërzitshëm i 'Uliksit'!



Nga: Amor TOWLES, shkrimtar i njohur amerikan (titulli original: Amor Towles: 'When I reread Ulysses I found it insufferable. Don't @ me')
Përkthimi: Telegrafi.com

Kur isha në klasën e parë – teksa jetoja në qarkun e Bostonit – shkrimtari i poezisë për të vegjël, David McCord, erdhi në klasën tonë për të lexuar diçka nga librat e vet. U mahnita nga gjithë kjo: nga imagjinata e tij, nga loja e tij me fjalë, nga mënyra se si poezia arrin tek audienca. E dija që atëherë se doja të bëhesha shkrimtar. Atë natë nisa të shkruaj poezi, njësoj si të tija, dhe që atëherë v lente kjo: lexo, shkruaj, përsërit.

Libri im i preferuar, teksa rritesha

Në moshën 13-vjeçare, shumë më përpara libri i Ray Bradburyt me tregime fantastiko-shkencore, Njeriu i ilustruar [The

Illustrated Man] – të cilin e zgjodha në panairin e librave shkollorë, duke u bazuar vetëm në kopertinën e tij. Për ditëlindjen time, disa vite më vonë, nëna ma dhuroi përmbledhjen e tregimeve të tij. Ishte hera e parë që lexova një autor, duke lëvizur në mënyrë kronologjike përgjatë dekadave të krijimtarisë të tij. Që atëherë, preferenca ime ka qenë që këtë ta bëjë me autorët të cilët unë i adhuroj.

Libri i cili më ndryshoi si adoleshent

Leximi gjithmonë nxitej në shtëpinë time. Por, kur isha në adoleshencën e hershme, babai herë pas here më jepte para për të lexuar librin të cilin ai ishte i bindur se do ta pëlqej, por nguroja ta kapja në dorë për shkak të trashësisë që kishte. Tre librat për të cilët më pagoi për t'i lexuar: Kryezoti i unazave [The Lord of the Rings] i JRR Tolkienit, Shoguni [Shōgun] i James Clavellit dhe Njëqind vjet vetmi

[One Hundred Years of Solitude] i Gabriel García Márquezit. I doja që të tre, por Njëqind vjet vetmi m'i hapi sytë drejt nivelit krejtësisht të ri të rrëfimit. Mbetet një nga tre librat e mi të preferuar (së bashku me Luftën dhe paqen të Tolstoyt dhe Moby-Dikun e Melvilleit).

Shkrimtari që ndryshoi mendjen time

Kur isha në kolegji, e përcolla një mik drejt një librerie të stripave. Nuk isha lexues i stripit dhe mbase atë formë e shihja me përbuzje. Por, ndodhi që atë javë doli numri i parë i Kthimit të Kalorësit të Errësirës [The Dark Knight Returns] i Frank Millerit. E mora dhe menjëherë u mahnita nga invencioni grafik, nga peshat psikologjike dhe ndërthurja tematike. Është e panevojshme të thuhet se i lexova të katër pjesët e serisë. Disa muaj më vonë doli numri i parë i Rojës [Watchmen] kreative të Alan Mooreit. Me shumë kënaqësi e ndoqa zhvillimin e

romanit grafik, në kulmet e reja si Miu [Maus] i Art Spiegelmanit dhe Persepolisi [Persepolis 1: The Story of a Childhood dhe Persepolis 2: The Story of a Return] i Marjane Satrapit.

Libri që rilexova

Veprat e Homerit janë pus që nuk thahet kurrë.

Libri të cilin nuk mund ta lexoj sërish

Për 20 vjet, kam lexuar me tre miq. Duke u takuar për çdo muaj, i ndjekim projektet, marrin një sërë novelash nga i njëjti autor, nga i njëjti rajon ose nga e njëjta periudhë kohore. Disa vjet më parë, vendosëm t'i rishikonim veprat e James Joyceit, të cilat që të gjithë ne i kishim lexuar në vitet e kolegjit. Dublinasit [Dubliners] ishte kaq shpikës në ndërtimin dhe përdorimin e gjuhës, aq i bukur në përshkrimin e njerëzve; e kam dashur më shumë si i rritur sesa si i ri. Por, Uliksi [Ulysses] tregoi

se ishte një përvojë e kundërt. Teksa u magjepsa si i ri, mu duk pothuajse i padurueshëm si i rritur. Mos më akuzoni [Don't @ me].

Librin të cilin e zbulova më vonë gjatë jetës

Kohët e fundit, tre miqtë e mi dhe unë i lexuam tri romane të ndërlihdura nga Alfred Hayesit: Në dashuri [In Love], Fytyra ime të cilën bota duhet ta shohë [My Face for the World to See] dhe Fundi im [The End of Me]. Puna e tij ishte zbulim për të gjithë ne. Është mjeshtër i nënvlerësuar amerikan.

Libri të cilin aktualisht po e lexoj

Po e lexojmë Deti, deti [The Sea, the Sea] të Iris Murdochut, pasi e kemi përfunduar së fundmi Princin e zi [The Black Prince]. Askush nga ne nuk e kishte lexuar Murdochun më parë dhe të gjithë jemi të kënaqur. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Trepça fiton ndeshjen e parë ndaj Prishtinës

MITROVICË, 21 PRILL - Trepça ka fituar ndeshjen e parë gjysmëfinale ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 87:81 (22:19, 21:20, 21:16, 23:26) Çereku i parë ishte pothuajse i barabartë me rikthime në rezultat, ku epërsinë më të lartë, e kishin vendasit pesë pikë,

18:13, derisa kjo pjesë përfundoi 22:19. Lojë e ngjashme u zhvillua edhe në periudhën e dytë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shpërbente, derisa pjesa e parë përfundoi 43:39. Periudha e tretë ishte vendimtare, ku vendasit e fituan 21:16, derisa në dhjetë minutat e

fundit e ruajtën epërsinë dhe triumfuan 87:81. Kevin Capers kishte 13 pikë, 4 kërcime e katër asistime te vendasit, kurse Diamond Stone kishte 23 pikë për bardhekaltrit. Loja e dytë do të zhvillohet të enjten në kryeqytet. Skuadra që shënon tri fitore do të kualifikohet në finale.



Llapi mposhti Fushën Kosovën, Prishtina u rikthehet fitoreve

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 PRILL - Skuadra e Llapit me mund të madh ka marrë tri pikë të plota ndaj Fushë Kosovës (1-0), në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Pas këtyre tri pikëve Llapi e barazoi kuotën e pikëve me Dritën (58) dhe tani ka vetëm dy pikë më pak se Ballkani. Fitoren ia siguroi Llapit, Ilir Krasniqi me golin e shënuar në minutën e parë shtesë, i cili realizoi me gjuajtje me kokë. Një rast të mirë paraprakisht Llapi pati Muhamet Hyseni që dështoi nga pika e bardhë. Pas kësaj ndeshje, Llapi ka 58 pikë. Fushë Kosova ka 20 pikë dhe është e parafundit dhe me gjasë edicionin tjetër do të bëjë gara në Ligën e Parë. Ndërkohë, të dielën Prishtina, pas tri barazimeve radhazi dhe disfatës

në xhiron e kaluar, është kthyer te fitorja dhe atë si mysafirë. Kryeqytetasit mposhtën Malishevën në stadiumin "Liman Gegaj", me rezultat 1-0. Golin e vetëm në këtë ballafaqim e shënoi Hasan Hyseni në minutën e 67-të, pas pasimit që mori nga Ardian Muja. Malisheva nga minuta e 71-të luajti pa sulmuesin Rilind Haziraj, që u përjashtua pasi u ndëshkua me karton të kuq. Prishtina pas 30 ndeshjeve zë vendin e pestë me 43 pikë, kurse Malisheva mbetet në vendin e katërt me 52 pikë. Derbi ndërmjet dy skuadrave të kreut të renditjes, Ballkanit dhe Dritës, i cili u zhvillua, të shtunën, në Suharekë, është mbyllur pa fitues, me rezultat 2-2. Kjo ndeshje solli emocione të mëdha dhe lojë mjaft cilësore, ku u shënuan katër gola. Blerim Krasniqi e kaloi Dritën në epërsi, me golin e shënuar në minutën e



51-të, por portokallezinjtë e rikthyen baraspeshën në rezultat shumë shpejt me golin e Gentrit Halili, në minutën e 54-t. Drita kaloi sërish në epërsi në minutën e 89-të, me supergolin e Ensar Huruglicës. Kur mysafirët po shkonin drejt një fitoreje tejte të rëndësishme, në skenë doli Nazmi Gripshi, i cili në frymën e fundit të ndeshjes shënoi për

rezultatit përfundimtar, 2-2. Pas këtij barazimi Ballkani ruajti pozitën e parë dhe tani ka 60 pikë, derisa Drita renditet e dyta me dy pikë më pak. Edhe dy ndeshjet e tjera përfunduan baras. Feronikeli 74 mori një pikë si mysafir ndaj Gjilanit, ndeshje e cila u mbyll 1-1. Senad Jaroviç shënoi për gjilanasit në minutën e 3-të, derisa një pikë skuadrës së

SUPERLIGA - Java e 30-të

Llapi - Fushë Kosova	1-0
Malisheva - Prishtina	0-1
Liria - Dukagjini	0-0
Ballkani - Drita	2-2
Gjilani Feronikeli 74	1-1

Tabela

		Pikë
1. Ballkani	30	60
2. Drita	30	58
3. Llapi	30	58
4. Malisheva	30	52
5. Prishtina	30	43
6. Dukagjini	30	38
7. Gjilani	30	34
8. Feronikeli 74	30	31
9. Fushë Kosova	30	20
10. Liria	30	11

drejtuar nga Shefki Kuqi ia siguroi Abdoul Razack Bachare Zoungrana, në minutën e 35-të. Ndërkohë, Dukagjini ka marrë vetëm një pikë në udhëtim, në Prizren, në duel me skuadrën e fundit në renditje, Lirinë, duke e mbyllur ndeshjen 0-0.

Reali fiton 'El Clasico'-n ndaj Barcelonës



MADRID, 21 PRILL - Nuk mund të kishite mbyllje më të bukur, të një "El Clasico", se një gol fitoreje në minutat e fundit të sfidës. "Galaktikët" e Real Madrid kanë arritur të dhurojnë spektakël mbrëmjen e kësaj të diele dhe pas një fitoreje të madhe, në çerekfinalet e Ligës së Kampionëve, ndaj Manchester City, kanë mundur në "Bernabeu", "Katalanasit" e Barcelona, në përballjen e javës së 32-të, të La Liga. Christensen e Fermin Lopez shënuan për skuadrën e teknikut, Xavi në minutat 6' e 69', mirëpo

Vinicius Junior, Lucaz Vazques e Jude Bellingham u treguan më të saktë, teksa arritën të shënojnë në minutat 18', 73' e 91' të sfidës, për të mahnitur të pranishmit në "Santiago Bernabeu", me një festival golash. Sa i përket renditjes, në tabelën e La Liga, "Galaktikët" e Real Madrid ngjiten në kuotën e 81 pikëve tashmë, duke qëndruar plot 11 pikë larg, nga "Blaugranat" e vendit të dytë, teksa dy fitore fnë javët e ardhshme, të kampionatit mund t'i dhuronin "Los Blancos", një tjetër titull kampion, të Spanjës.

Vushtrria e fiton ndeshjen e fundit kampionate

VUSHTRRI, 21 MAJ - Vushtrria e ka përfunduar me fitore edicionin 2023/2024 në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Të dielën mbrëma në kuadër të xhiros së 28-të, vushtrriasit, që ishin vendas,

fituan ndaj Vëllaznimit me rezultat 31:26. Mysafirët nga Gjakova ishin në epërsi 16:15 pas pjesës së parë. Por në të dytën më shumë shfaqën hendbollistët vendas që fituan me pesë gola dallim. Fitim

Klinaku i shënoi 11 gola për Vushtrrinë, derisa gjashtë i kishte Erkan Abazxhiku. Labinot Kërleshi, Luigj Kolaj e Egzon Lluka i shënuan nga shtatë gola për Vëllaznimin. Vushtrria e përfundoi

kampionatin në pozitën e gjashtë me 15 pikë. Vëllaznimi është i shtati me tetë pikë, ndërsa e ka një ndeshje më pak të luajtur. Vëllaznimi do të luaj në barazh për vendin në Superligë.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

